

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 220/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 06.03.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi deri në 100.00 € (njëqind euro) që Komuna do të paguajë nga fondi për transfere dhe subvencione, për secilin ndjekës të trajnimit, banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë, të cilët e përfundojnë me sukses trajnimin në SPEEEX Edukation në Vushtri ose ndonjë kompani tjetër e licencuar e cila ushtron veprimtari të njëjtë në Vushtri apo kudo në Kosovë.
2. Pagesat nga pika 1 e këtij vendimi do të kryhen nga komuna për modulet e të mësuarit të gjuhës Gjermane apo Frënge.
3. Pagesa e mjeteve bëhet në llogari të secilit person që ka përfunduar me sukses trajnimin tre (3) mujorë dhe është pajisur me certifikatë nga SPEEEX Edukation në Vushtri apo kompani tjetër legale në Vushtri e cila ka kryer trajnime të fushave të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi, që mund të ofrojnë ofertë pune pas përfundimit të trajnimit. Pagesa bëhet në emër të personit që e ka kryer trajnimin, apo përfaqësuesit ligjorë, ose njërit prind nëse përfituesi i këtyre mjeteve është i moshës jo madhore.
4. Me rastin e aplikimit për këtë subvencion, duhet dorëzuar në zyrën pritëse të komunës: Kërkesa, adresuar për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Certifikata valide nga kompania për kryerje të trajnimit, dëshmia për pagësë në llogari të kompanisë, si dhe Ekstrakti i lindjes me të cilën dëshmohet se është banor rezident i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Për shkak të mbylljes së pagesave të vitit 2023 në muajin dhjetor 2023, aplikacionet e arritura pas datës së mbylljes së pagesave, të realizohen me buxhetin e vitit 2024. E njëjta gjë vlen edhe për aplikacionet e arritura pas mbylljes së pagesave në muajin dhjetor 2024 të cilat paguhen në fillim të vitit 2025.
7. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet nga data 03 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2025.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë